



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë-Albania, Tel.04 2512-67*

Nr. 208 / Prot.

Tiranë, më 03/02/2012

**Lënda:** *Për kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të KLSH.*

**Zj. Edmond SPAHO**

**Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në  
Kuvendin e Shqipërisë**

**TIRANË**

Më lejoni t'ju bëj me dije se në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ka mbi 10 vjet që nuk është ushtruar kontroll i llogarive të tij. Kontrolli i fundit i kryer nga ekspertë të caktuar nga Kuvendi ka përfunduar në muajin prill të vitit 2001, ndërkohë që në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, nen 3, paragrafi i tretë, përcaktohet:

"KLSH duhet çdo vit të përgatisë llogaritë e tij në përputhje me ligjin për buxhetin. Llogaritë e tij kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe raporton te ky".

Cilësojmë se, çështja e kontrollit të llogarive vjetore të KLSH është trajtuar dhe në Kuvendin e Shqipërisë, mjafton të citoj rezolutën e Kuvendit me nr. 1250 prot., datë 5.5.2010 "Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2009", ku ndër objektivat e përcaktuara nga Kuvendi për vitin 2010, renditet dhe objekti "Realizimi i detyrimit ligor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të KLSH".

Ne i jemi drejtuar Kryetares së Kuvendit Zj. Jozefina Topalli me shkresën nr. 208, datë 02.02.2012 ku kërkojmë zhvillimin e auditimit nga organizmi që do të caktojë Kuvendi.

Përsa më sipër, kërkoj mbështetjen Tuaj për trajtimin me prioritet të kërkesës tonë për auditim.

**KRYETARI  
Bujar LESKAJ**

